

**S T A T U T**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“GASTRONOMY & MARKETING” SHPK**

**KREU I**  
**Dispozita të Përgjithshme**

**Neni 1**  
**Emërtimi i shoqërisë dhe Ortakët**

- 1- Emërtimi i shoqërisë është **“GASTRONOMY & MARKETING” Shpk .**
- 2- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Gastronomy & Marketing” Shpk** është themeluar sipas këtij statuti të përpiluar dhe nënshkruar nga ortakët e shoqërisë :
- ❖ Shoqëria **“FOOD CONCEPT” Shpk** , person juridik Shqipëtar regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt M31821506R përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administrator i shoqërisë **Z.LORVAL PETANI** I biri I **ANESTI**-it dhe **LULJETA**-s, i datëlindjes 13.06.1977, shtetas Shqipëtar lindur e banues ne **DURRES**, me ID. H70905142B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar .
- Dhe
- ❖ **Z.AGRON ÇOPJA** I biri I **KUJTIM**-it dhe **NADIRE**-s, i datëlindjes 17.04.1969, shtetas Shqipëtar lindur në **ELBASAN** e banues ne **DURRES**, me ID. G20417009Q, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar .

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

- 1- Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti krijohet me mjetet në pronësi private të themeluesve të saj.
- 2- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Gastronomy & Marketing” Shpk** në përputhje me vendimin për krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.
- 3- Shoqëria **“Gastronomy & Marketing” Shpk** e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .
- 4- Shoqëria është person juridik Shqipëtar dhe zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin 9901 datë.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ky statut.

**Neni 3**  
**Selia e shoqërisë**

- 1- Selia e shoqërisë **“Gastronomy & Marketing” Shpk** është në adresën: **Terminali i Trageteve, Porti i Durrësit .**
- 2- Shoqëria ushtron veprimtarinë e vet të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3- Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, zyra dhe filiale të saj të përfaqësimit brenda dhe jashtë vëndit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vëndit ku është hapur.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

- 1- Import - Eksport , aktivitet tregtar në fushën e bar, restorant, marketing, logistic, shërbime të tjera që kanë lidhje me to, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

- 1- Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimi në Regjistrin Tregtar .
- 2- Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**Neni 6**  
**Vula e shoqërisë**

- 1- Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen : **“Gastronomy & Marketing” Shpk**

**Neni 7**  
**Administratori dhe emërimi i tyre**

- 1- Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Lorval Petani**.
- 2- Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej **5 vjetësh** financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm.
- 3- Administratorët do të emërohen në vijim me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme
- 4- Shoqëria sipas nevojave të saj mund të administrohet nga 2 (dy) administratorë .
- 5- Administratorët janë persona fizik që mund të zgjidhen dhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë .

**Neni 8**  
**Kapitali dhe kuotat**

- 1- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (Një qindëmijë) Lekë**
- 2- Kapitali themeltar përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale 50.000 (Pesë dhjetëmijë) Lekë / kuotë.
- 3- Pjesmarrja e themeluesit të shoqërisë në përputhje me kontributin është si më poshtë:
  - Ortaku themelues Shoqëria **“Food Concept” Shpk Nipt M31821506R**
    - Vlera e kontributit në lekë , 50.000 (Pesë dhjetëmijë) Lekë
    - Kuotat e zotërimit të kapitalit – 50 % (pesëdhjetë përqindë)
  - Ortaku themelues Agron Çopja.
    - Vlera e kontributit në lekë , 50.000 (Pesë dhjetëmijë) Lekë
    - Kuotat e zotërimit të kapitalit – 50 % (pesëdhjetë përqindë)

### **Neni 9**

- 1- Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.
- 2- Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët e saj, të kenë pavarësi ligjore, për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie.
- 3- Ato nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tek kapitali themelor ku ata kanë marrë pjesë.

### **Neni 10**

#### **Të drejtat e ortakëve të shoqërisë**

**Ortakët e kësaj shoqërie kanë këto të drejta kryesore :**

- 1- Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.
- 2- Të marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në çdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin dhe aktin e themelimit.
- 3- Të marrin pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ose vetë.
- 4- Të kërkojnë të japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjëndjen tregëtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentet e përpunuara të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj.
- 5- Të bëjnë propozime dhe ti paraqesin ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
- 6- Të emërojnë dhe shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

### **Neni 10**

#### **Detyrat e ortakëve të shoqërisë**

**Ortakët kanë këto detyra kryesore :**

- 1- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tyre, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijojnë.
- 2- Ti japin shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- 3- Të kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

## **KREU II**

### **Kushtet ekonomike**

### **Neni 11**

- 1- Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabël dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

### **Neni 12**

- 1- Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të saj nga ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij në mënyrë proporcionale.

### Neni 13

- 1- Pjesa e kapitalit themeltar është plotësisht e transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve dhe paraardhësve e pasardhësve.
- 2- Transferimi i pjesës të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt noterial.

### Neni 14

- 1- Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në perputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytezojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

### Neni 15

- 1- Shoqëria krijon fonde rezervë ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.
- 2- Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj, mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakëve, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

## KREU III

### Viti financiar, llogaritë vjetore, ndarja e fitimit.

### Neni 16

- 1- Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
- 2- Përfundimisht viti i parë financiar ka filluar në ditën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon me 31 dhjetor të vitit 2023.

### Neni 17

- 1- Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga të dy ortakët. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

### Neni 18

- 1- Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lëna rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregëtare etj, e përfitojnë ortakët e shoqërisë Shoqëria "Food Concept" Shpk Nipt M31821506R në masën 50 % të kuotave dhe Agron Çopja në masën 50 % të kuotave

#### **Neni 19**

- 1- Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brënda 31 marsit të vitit pasardhës.

### **KREU IV** **Administrimi**

#### **Neni 20**

- 1- Ortakët përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në formën e kapitalit themeltar.

#### **Neni 21**

- 1- Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme

#### **Neni 22**

- 1- Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhja e asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
- 2- Mbledhja e zakonshme e Asamblesë vendos për çështje të tilla si emrin ose shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore.
- 3- Mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë vendos për çështje të tilla si ndryshimi i stautit, zvogëlimi i pjesëve të kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjesës të kapitalit themeltar, shëndërrimin e shoqërisë nga shpk në forma të tjera, mbylljen e shoqërisë para kohe, të ndarjes së fitimit.

#### **Neni 23**

- 1- Administrimi i shoqërisë bëhet nga Administratori/ët e shoqërisë, i cili ka edhe funksionin e përfaqësuesve të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë e saj.

#### **Neni 24**

- 1- Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori/ët ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektivin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh.
- 2- Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkeljet e ligjeve, të statutit, apo për faj të tyre gjatë administrimit të shoqërisë .

## Neni 25

### Të drejtat e administratorit në shoqëri janë :

- 1- Të miratoj planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.
- 2- Të bëjnë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblesë, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3- Të miratoj aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- 4- Të përcaktoj strukturën e aparatit të shoqërisë.
- 5- Të krijoj organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- 6- Të propozoj në mbledhjen e asamblesë për krijimin e njësive, strukturave si filiale, dege e përfaqesi në qytete të tjera të vëndit apo jashtë shtetit.
- 7- Të përgatis propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqes ato asamblesë për miratim.
- 8- Të përzgjedh ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqes propozimet për miratim në asamble.
- 9- Të siguroj zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë.
- 10- Të përcaktoj numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.

## Neni 26

- 1- Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar i emëruar për pesë vite finansiare. Ai caktohet nga ortakët e shoqërisë. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrave.

## KREU V Marrëdhëniet e punës

### Neni 27

- 1- Marëveshja e punës në shoqëri rregullohet në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionin shqiptar dhe me këtë statut.

### Neni 28

- 1- Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet në bazë të kontratës kolektive dhe individuale të punës.
- 2- Në kontratën e punës rregullohen këto çështje :
  - Kushtet dhe mënyra e marrëdhënieve në punë.
  - Fillimi i punës së punonjësve dhe caktimi i tyre në vendin e punës.
  - Koha e punës dhe caktimi i kohës së punës.
  - Puna jashtë kohës normale, puna në ditët e pushimit javor, festave zyrtare.
  - Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.

- Pushimet dhe mungesat.
  - Të drejtat detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve për zbatimin e detyrave të punës.
  - Paga e punës së punonjësve, shpërblimi i punës dhe shpërblime të tjera.
- 3- Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj, në organet përkatëse, duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 29**

- 1- Për të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin, gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë Durrës.

### **KREU VI** **Mbyllja e Shoqërisë**

#### **Neni 30**

- 1- Veprimtaria e shoqërisë mbaron në afatin e përcaktuar në aktin e themelimit. Veprimtaria e shoqërisë mund të mbyllet edhe kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshëm veprimtaria e shoqërisë nuk rezulton rentabël, ose kur ortakët e saj heqin dorë nga shoqëria.

#### **Neni 31**

- 1- Kur shoqëria likuidohet asambleja mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet për miratim bilancin e likuidimit të shoqërisë.
- 2- Shoqëria i jep fund veprimtarisë në çastin e miratimit të bilancit të likuidimit.

#### **Neni 32**

- 1- Mjetet financiare si dhe çdo pronësi tjetër e fituar si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë kur shoqëria likuidohet, ju takon ortakëve në masën 50% për Shoqërinë "Food Concept" Shpk Nipt M31821506R dhe 50% për Z. Agron Çopja, pasi të jenë zbritur dhe bërë pagesat për të gjithë kreditorët e shoqërisë.

### **KREU VIII** **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 33**

- 1- Të gjitha veprimet e shoqërisë regjistrohen në një libër të vecantë që mbahen në selinë e shoqërisë.




Ky statut është hartuar sot më datën 14 .07.2023

NËNSHKRIMI I ORTAKËVE

PËR  
SHOQËRINË “FOOD CONCEPT” SHPK  
ADMINISTRATOR

\_\_\_\_\_  
LORVAL PETANI



\_\_\_\_\_  
AGRON ÇOPJA

